

GJON BORIÇI**VARËSIA E MBIJETESËS EKONOMIKE TË SHQIPËRISË
NGA NDIHMAT DHE KREDITË E KAMPIT SOCIALIST
DHE TË REPUBLIKËS POPULLORE TË KINËS
1956-1962****Viti 1956 dhe mundësitë e afrimit
të plotë shqiptaro-kinez**

Viti 1956 shënon një tjetër afrim të marrëdhënieve të Republikës Popullore të Shqipërisë [më tej: RPSH] me Republikën Popullore të Kinës [më tej: RPK]. Pas Kongresit XX të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, Enver Hoxha do të fillonte të kthente sytë përherë e më tepër nga RPK e Mao Ce Dunit. Kina nga ana e saj po shikonte tek Shqipëria një urë të rëndësishme në Evropë. Pas konferencës së Gjenevës të vitit 1954, Shtetet e Bashkuara të Amerikës kishin thelluar izolimin ndërkombëtar të RPK-së.¹ Nga ana e tij, Enver Hoxha i kishte mbijetuar politikisht Konferencës së Partisë të Tiranës, të prillit 1956.²

Pas përfundimit të Konferencës së Tiranës, më 26 prill 1956, kryeministri i Shqipërisë, Mehmet Shehu i shkroi një letër kryeministrit kinez Çu En Lai për t'i dërguar Shqipërisë një kredi të re për planin e dytë pesëvjeçar 1956-1960.³ Për këto vite Shqipëria kërkonte nga Kina një kredi prej 50 milion rublash.⁴ Mehmet Shehu i kërkonte Çu En Lait që shlyerja e kësaj kredie të fillonte pas vitit 1980 me 0.5% të vlerës së saj.⁵ Ajo çfarë të bën përshtypje tek kërkesa shqiptare është se qeveria e RPSH-së ende nuk kishte përcaktuar se çfarë mallrash kërkonte të merrte nga kredia e mësipërme për vitet 1956-1960.⁶ Mehmet Shehu sqaronte se

¹ Henry Kissinger, *On China*, London: Penguin, 2011, f. 158-160

² Ana Lalaj, *Pranvera e rrejtshme e '56-ës*, Tiranë: Infbotues, 2015, f. 19, 62.

³ Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (më tej: AQSH), Fondi (më tej: F.) 490/Këshilli i Ministrave (më tej: KM), Viti (më tej: V.) 1956, Dosja (më tej: D.) 1231, fl. 3. Kërkesë kredie për 5-vjeçarin e dytë 1956-1960, Qeverisë R.P. të Kinës.

⁴ *Po aty*, fl. 4.

⁵ *Po aty*.

⁶ *Po aty*.

për mallrat që do të bliheshin me kredi nga Kina, lista do të paraqitej përgjatë vitit 1957.⁷

Pas vizitës së parë të Enver Hoxhës në Kinë, më 26 nëntor 1956, ambasadori kinez në Tiranë Sju I Sin i dërgoi një letër kryeministrit të RPSH-së, ku e njoftoi se qeveria kineze do t'i akordonte Shqipërisë një kredi falas prej 30 milionë rublash.⁸ Përpara letrës së ambasadorit kinez, më 21 nëntor 1956, kryeministri Shehu i kishte shkruar homologut të tij kinez Çu En Lai për të marrë nga Kina 60 mijë ton grurë, 5 mijë ton yndyrna dhe 2 mijë ton oriz.⁹ Kërkesën kryeministri shqiptar e justifikonte se Shqipëria gjendej në vështirësi serioze ekonomike për shkak kushteve klimaterike jo të favorshme që kishte kaluar vendi gjatë këtij viti.¹⁰ Shehu i shpjegoi kryeministrit kinez se për vitin 1956 Shqipëria nuk kishte krijuar asnjë rezervë në drithëra buke, oriz dhe yndyrna ushqimore.¹¹ Përveç kushteve të këqija klimaterike, kryeministri Shehu i lidhte vështirësitë ekonomike të Shqipërisë edhe me gjendjen e nderë ndërkombëtare.¹² Mehmet Shehu i lutej kryeministrit kinez që gruri, orizi dhe yndyrnat ushqimore të dërgoheshin po të ishte e mundur brenda tremujorit të parë të vitit 1957.

Letrës së Mehmet Shehut, qeveria kineze iu përgjigj nëpërmjet zëvendëskryeministrit Çen Jun më datë 12 dhjetor 1956.¹³ Në letrën e qeverisë kineze shprehej gatishmëria për të ndihmuar popullin shqiptar, por jo në maksimumin e kërkesave që kishte parashtruar Mehmet Shehu. Zëvendëskryeministri kinez Çen Jun njoftoi homologun e tij shqiptar se edhe konditat ekonomike të Kinës nuk ishin shumë të mira, ndaj Shqipërisë do t'i jepej vetëm 50 000 ton grurë, 2000 ton oriz dhe 2500

⁷ *Po aty*.

⁸ *Po aty*, F. 490/KM, V. 1956, D. 1230, fl. 4. Pjesë nga letra e ambasadorit kinez: "...Qeveria e Republikës Popullore të Kinës vendosi t'i japë pa kthim si dhuratë Qeverisë Popullore të Shqipërisë 30 milion rubla dhe i propozon që organet e tregtisë së jashtme të të dy vendeve të shqyrtojnë mënyrat konkrete për përdorimin e tyre".

⁹ *Po aty*, fl. 6.

¹⁰ *Po aty*.

¹¹ *Po aty*.

¹² *Po aty*. Pjesë nga letra e Mehmet Shehut drejtuar Çu En Lait: "Dihet se gjendja ndërkombëtare e sotme është në një fazë të ngritjes së tensionit në përgjithësi dhe veçanërisht në zonën e Mesdheut. Në këtë situatë ndërkombëtare neve nuk na lejohet që të qëndrojmë pa rezervat minimale në sendet ushqimore të popullit".

¹³ *Po aty*, fl. 10.

ton yndyrna ushqimore.¹⁴ Gjithashtu, zëvendëskryeministri kinez i premtonte Mehmet Shehut se qeveria kineze do të bënte ç'ishte e mundur që mallrat të dërgoheshin në Shqipëri brenda tremujorit të parë dhe të dytë të vitit 1957.¹⁵

Këto ndihma nga RPK kishin vlerë të madhe për qeverinë e RPSH-së. Me një letër të datës 12 dhjetor 1956, kryeministri Mehmet Shehu falënderoi ngrohtësisht homologun e tij kinez Çu En Lai për këtë ndihmë të madhe që Kina po i jepte Shqipërisë.¹⁶ Sipas Mehmet Shehut, vitet e fundit marrëdhëniet shqiptaro-kineze po merrnin një hov dhe zhvillim shumë të madh në frymën e mirëkuptimit të thellë reciprok.¹⁷ Në mënyrë që marrëdhëniet me Kinën të forcoheshin akoma më shumë, më 28 dhjetor 1956, kryeministri Mehmet Shehu i dërgoi një letër kryeministrit kinez Çu En Lai ku e ftonte në kohën që ai do ta gjykonte të përshtatshme të vizitonte Shqipërinë.¹⁸ Sipas Shehut, kjo vizitë kurdo që të realizohej do të shërbente për të forcuar akoma më shumë marrëdhëniet vëllazërore ndërmjet popullit shqiptar dhe atij kinez.¹⁹

Kërkesa të shumta për kredi nga i gjithë Kampi Lindor për pesëvjeçarin e tretë 1961 – 1965

Pasi mori nga Kina një kredi falas prej 30 milionë rublash për pesëvjeçarin e dytë, ende pa mbaruar vitet '50, Shqipëria iu drejtua kësaj radhe të gjitha vendeve të demokracive popullore për të marrë kredi nga ato, pasi situata ekonomike që po kalonte vendi dhe mungesat në investime po e rëndonin akoma më shumë mirëqenien e banorëve. Padyshim, vendit të parë që qeveria e RPSH iu drejtua ishte Bashkimi Sovjetik. Më 7 tetor 1958, sekretari i parë Komitetit Qendror të PPSH-së, Enver Hoxha i dërgoi një letër të gjatë sekretarit të parë të Partisë

¹⁴ *Po aty*.

¹⁵ *Po aty*.

¹⁶ *Po aty*, fl. 11.

¹⁷ *Po aty*.

¹⁸ *Po aty*, fl. 15. Pjesë nga letra e Mehmet Shehut: "...në emër të Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë, kam nderin t'ju ftoj Juve, shoku Kryetar i Këshillit të Shtetit, për të vizituar Republikën Popullore të Shqipërisë në kohën që do ta çmoni të përshtatshme".

¹⁹ *Po aty*, fl. 16.

Komuniste të Bashkimit Sovjetik, Nikita Hrushov.²⁰ Në letër, Hoxha përpiqet t'i shpjegojë Hrushovit arsyet se përse Shqipëria kishte nevojë për kredi nga ana e Bashkimit Sovjetik. Enver Hoxha që në fillim të letrës i shkruan Hrushovit sesa të larta ishin zhvillimet në prodhimet industriale në vend duke i krahasuar ato me prodhimet e para luftës.²¹ Për sukseset e mëdha që kishte korrur populli shqiptar në ndërtimin e socializmit ishte meritë e punës vetëmohuese të tij dhe mbi të gjitha i ndihmës bujare nga ana e Bashkimit Sovjetik.²² Por, edhe pse sukseset, sipas Hoxhës, ishin të mëdha, ato përsëri ishin të pamjaftueshme. Sipas tij, pesëvjeçari i parë dhe i dytë ishin thjesht hapi i parë drejt procesit të industrializimit.²³ Bujqësia dhe industria shqiptare kishin ende ritme të ulëta zhvillimi dhe ishin ende larg nivelit të jetesës së vendeve fqinj Greqisë, Jugosllavisë dhe Italisë.²⁴

Enver Hoxha synonte që me ndihmën në kredi nga ana e Bashkimit Sovjetik ta kthente vendin nga agraro-industrial në industrialo-agrar. E gjithë kjo, sipas tij duhej të realizohej në pesëvjeçarin e tretë 1961-1965.²⁵ Sipas Hoxhës, në planin e tretë pesëvjeçar parashikohej të rritej prodhimi industrial në masën 72% me një ritëm mesatar vjetor prej 11.9%.²⁶ Po ashtu, volumi i ndërtimeve rreth 83% më i madh.²⁷ Zhvillimi i sektorit të minierave kishte rëndësi të veçantë për ekonominë shqiptare sipas Hoxhës pasi ato dhe veçanërisht industria e naftës kishin relativisht perspektivë të madhe zhvillimi.²⁸ Industria e naftës vetëm për pajisjet që do të importoheshin kërkonte mbi 400 milionë rubla.²⁹ Me këtë investim

²⁰AQSH, F. 490/KM, V. 1958, D. 1125, fl. 1. Letër e Komitetit Qendror të PPSH-së për kredi për 5-vjeçarin III 1961-1965.

²¹Po aty. Pjesë nga letra e Enver Hoxhës dërguar Nikita Hrushovit: "Prodhimi industrial për vitin 1958 është rreth 17.6 herë më i madh dhe prodhimi bujqësor rreth 120% më i madh se para luftës. Prodhimi industrial tash përbën rreth 47% dhe prodhimi bujqësor rreth 53% të volumit të përgjithshëm të prodhimit industrial e bujqësor".

²²Po aty, fl. 2.

²³Po aty.

²⁴Po aty.

²⁵Po aty.

²⁶Po aty, fl. 3.

²⁷Po aty.

²⁸Po aty. "...prandaj kemi parashikuar që në pesëvjeçarin e tretë prodhimi i industrisë së naftës të rritet 100%, i industrisë së kromit 21%, i industrisë së bakrit 75%, i industrisë së qymyrgurit 53%, nxjerrja e mineralit hekur-nikelit 150%".

²⁹Po aty, fl. 4.

parashikohej që në vitin 1965 rezervat e Shqipërisë me naftë do të kapnin shifrën 2.5 milion ton.³⁰

Zhvillimi i industrisë së rëndë ishte prioritar në politikat ekonomike të qeverisë shqiptare. Nga hulumtimi i kujdesshëm i këtij dokumenti, kërkesat për investime në bujqësi dhe industrinë e lehtë nuk janë aq të detajuara si ato të industrisë së rëndë. Uzina e plehut azotik dhe kombinati kimiko-metalurgjik ishin padyshim dy veprat madhore që do t'i kushtonin Shqipërisë një pjesë të mirë të kredisë. Mijëra ton helme e kimikate do të prodhonin këto fabrika të cilat do t'i shkaktonin dëme të mëdha jo vetëm ekonomisë shqiptare, por edhe mjedisit. Kombinati kimiko-metalurgjik do të kishte në përbërje të tij disa uzina si ajo e plehut fosfatik me kapacitet 100 mijë ton superfosfat në vit, uzina e prodhimit të acidit sulfurik me kapacitet 70 mijë ton në vit, uzina e shkrirjes së bakrit me kapacitet 2500 ton bakër blister në vit dhe me perspektivë zgjerimi në 500 ton në vit, uzina e ferro-kromit me kapacitet 37 mijë ton ferrokrom në vit dhe uzina e prodhimit të sulfatit të bakrit me kapacitet 4000 ton në vit.³¹

Po për pesëvjeçarin e tretë, Shqipëria me anë të kësaj letre sqaruese të Enver Hoxhës parashikonte të ngrinte një industri të tërë për përdorimin e gazit të naftës me fabrika që do të ndërtoheshin në Qytetin Stalin (sot Kuçovë), Vlorë, Durrës, Elbasan dhe Tiranë.³² Gjithashtu, me paratë sovjetike parashikoheshin të ndërtohej një TEC (pa specifikuar se ku) me kapacitet 48 mijë kw dhe me perspektivë zgjerimi gjer në 72 mijë kw në bazë të gazit të naftës.³³ Për industrinë e komunikacioneve (rrugët dhe hekurudhat) investimet parashikoheshin vetëm 11%³⁴, kur në fakt do të duhej të zinin pas bujqësisë investimet më të mëdha për të shndërruar Shqipërinë në një atraksion turistik. Enver Hoxha shpjegonte në këtë letër se ishte i ndërgjegjshëm për shpenzimet e mëdha që kërkonte pesëvjeçari i tretë dhe se rritja e eksporteve do të bënte të mundur që Shqipëria të ecte me këmbët e veta ekonomikisht vetëm nga fundi i pesëvjeçarit të katërt.³⁵ Për Enver Hoxhën, realizimi i investimeve të pesëvjeçarit të tretë

³⁰ *Po aty.*

³¹ *Po aty*, fl. 6.

³² *Po aty.*

³³ *Po aty.*

³⁴ *Po aty.*

³⁵ *Po aty*, fl. 7.

do të çelte perspektivën për ngritjen e nivelit të jetesës së masave punonjëse në një masë më të madhe në pesëvjeçarin e katërt.³⁶

Por si mund të rritej ekonomia dhe mirëqenia e shqiptarëve në pesëvjeçarin e katërt kur vetë Enver Hoxha pranon në këtë letër se bilanci i pagesave që duhej të kryente vendi për të përmbushur pesëvjeçarin e tretë ishte 700 milion rubla.³⁷ Për ta ulur Shqipërinë me këmbë në tokë, Bashkimi Sovjetik kishte dërguar në vitin 1957 një grup ekspertësh dhe specialistësh për hartimin e planeve 5-vjeçare duke filluar nga viti 1961 e duke përfunduar më 1975 dhe për të studiuar mundësinë e zhvillimit perspektiv të Shqipërisë.³⁸ Sipas ekspertëve sovjetikë, me të cilët bie dakord edhe vetë Hoxha, Shqipëria do të mund të ecte me këmbët e veta vetëm nga viti 1970 dhe deri atëherë e kishte të domosdoshme të merrte kredi nga vendet miq.³⁹ Për këtë arsye, Enver Hoxha në emër të KQ të PPSH-së i kërkoi Komitetit Qendror të PKBS një kredi prej 400 milion rublash për pesëvjeçarin e tretë 1961-1965.⁴⁰ Ndërsa për industrinë e naftës, Enver Hoxha i kërkoi në po të njëjtën letër Hrushovit një kredi prej 35 milionë rublash për të blerë pajisje për këtë industri vetëm për vitet 1959 dhe 1960.⁴¹ Në fund të letrës, Enver Hoxha e vë në dijeni Hrushovin se Shqipëria do t'i drejtohej për kredi edhe vendeve të tjera të demokracive popullore për të realizuar me çdo kusht me sukses sipas tij pesëvjeçarin e tretë.⁴²

Republikës Çekosllovaqe, Shqipëria i kërkoi 125 milion rubla; Republikës Demokratike Gjermane 70 milion rubla; Republikës Popullore të Polonisë 30 milion rubla; Republikës Popullore të Hungarisë 30 milion rubla; Republikës Popullore të Rumanisë 30 milion rubla; Republikës Popullore të Bullgarisë 40 milion rubla; Republikës Popullore të Kinës 55 milion rubla. Gjithsej Shqipëria vetëm nga këto vende kërkonte 380 milion rubla.⁴³

³⁶ *Po aty.*

³⁷ *Po aty*, fl. 8.

³⁸ *Po aty.*

³⁹ *Po aty.*

⁴⁰ *Po aty.*

⁴¹ *Po aty*, fl. 9.

⁴² *Po aty.*

⁴³ *Po aty*, fl. 12. Lista e kërkesave për kredi të re për pesëvjeçarin e tretë 1961-1965 vendeve të demokracive popullore.

Po me të njëjtën datë (7 tetor 1958) iu dërgua letër nga Enver Hoxha edhe Mao Ce Dunit për kredinë 55 milion rubla* nga ana e Kinës.⁴⁴ Edhe përmbajtja e kësaj letre është në frymën e letrës dërguar Nikita Hrushovit. Por, në dallim nga letra për në BS, Enver Hoxha sqaronte Mao Ce Dunit se kredia prej 55 milion rublash i duhej Shqipërisë për t'u përdorur për zhvillimin e industrisë tekstile si dhe për sigurimin e materialeve dhe makinerive të ndryshme, sikurse paraqitej tek lidhja që i bashkëngjitej kësaj letre.⁴⁵

Të gjitha letrat që iu janë dërguar komiteteve qendrorë të demokracive popullore janë dërguar të gjitha në të njëjtën ditë. Letrat janë njëlloj në përmbajtje vetëm kanë ndryshim tek pjesa ku sqarohet se përse kërkohet kredia. Tek letra dërguar Komitetit Qendror të Republikës Popullore të Bullgarisë për kredi 40 milionë rubla, përpiquej të jepej justifikimi se duhet të bliheshin atje pajisjet e nevojshme për ndërtimin e katër fabrikave të tullave dhe për ndërtimin e 12 fabrikave për përpunimin e rrushit sipas lidhjeve që i bashkëngjiteshin kësaj letre.⁴⁶ Në letrën dërguar Komitetit Qendror të Republikës Popullore të Rumanisë, kërkesa për kredi justifikohet se 30 milionë rublat që kërkoheshin do të përdoreshin për të blerë atje pajisjet për zhvillimin e industrisë së naftës, industrisë së drurit etj., sikurse paraqitej në lidhjen që i bashkëngjitej kësaj letre.⁴⁷ Në letrën dërguar Komitetit Qendror të Republikës Popullore të Hungarisë, kërkesa për kredi 30 milionë rubla justifikohet se do të bliheshin atje pajisje për zhvillimin e industrisë ushqimore, për zhvillimin e transportit etj., sipas lidhjes që i bashkëngjitej kësaj letre.⁴⁸ Në letrën dërguar Komitetit Qendror të Republikës Popullore të Polonisë kërkesa për kredi 30 milionë justifikohet për të blerë atje pajisjet e nevojshme për zhvillimin e transportit hekurudhor, të transportit automobilistik dhe industrisë së materialeve të ndërtimit sikurse paraqitej në lidhjen që shoqëronte letrën.⁴⁹ Në letrën dërguar Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Republikës Demokratike Gjermane, kërkesa për

* Shih artikullin tim: "Kreditë dhe ndihmat kineze për Shqipërinë 1956-1975", në *Studime historike*, nr. 3/4, Tiranë: 2018.

⁴⁴ Po aty, fl. 27, 33. Letër Mao Ce Dunit nga Enver Hoxha më 7 tetor 1958.

⁴⁵ Po aty, fl. 33.

⁴⁶ Po aty, fl. 46, 50. Letër Teodor Zhivkovit nga Enver Hoxha më 7 tetor 1958.

⁴⁷ Po aty, fl. 54, 66. Letër Georghiu Deit nga Enver Hoxha më 7 tetor 1958.

⁴⁸ Po aty, fl. 77, 89. Letër Janosh Kadarit nga Enver Hoxha më 7 tetor 1958.

⁴⁹ Po aty, fl. 92, 96. Letër Vladislav Gomulkës nga Enver Hoxha më 7 tetor 1958.

kredi 70 milionë rublash justifikohet për të blerë atje pajisje për zhvillimin e industrisë së drurit, industrisë ushqimore, industrisë lokale, të transportit detar etj. sikurse paraqitet në lidhjen që i bashkëngjitet kësaj letre.⁵⁰ Në letrën dërguar Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Çekoslovakisë, kërkesa për kredi 125 milionë rubla justifikohet për të blerë atje pajisjet e nevojshme për të ndërtuar objektet që paraqiteshin në lidhjen bashkëngjitur kësaj letre.⁵¹ Pajisjet më të shumta që kërkoheshin për t'u blerë në Çekoslovakia kishin të bënin me ndërtimin e kombinatit kimiko-metalurgjik, uzinën e acid-sulfurikut, uzinën e plehut azotik, uzinën e ferro-kromit, fabrikën për pasurimin e kromit, pajisje për mekanizimin e një miniere bakri, fabrikë për prodhim eterniti, uzinë mekanike, ofiçina për riparim automjesh, zgjerimin e ofiçinës automobilistike në Tiranë, fabrikën e këpucëve për prodhim 1 milion palë në vit me dy ndërresa.⁵²

Kërkesa Kinës për drithëra dhe ushqime

Situata ndërkombëtare pas Konferencës së Gjenevës e vitit 1954 nuk ishte e mirë. Viti 1958 ishte një vit krizash dhe acarimi marrëdhëniesh ndërmjet Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Sovjetik. Po në këtë vit, ndodh edhe kriza në ngushticën e Tajvanit ndërmjet Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Republikës Popullore të Kinës. Tajvani ishte pika nevralgjike nga e cila Kina shihte cenimin e kapaciteteve të saj për mbrojtje. Për këtë arsye kriza e ngushticës së Tajvanit e vitit 1954 dhe mbi të gjitha ajo e vitit 1958, hapën rrugën për investime strategjike kineze në industrinë e armatimit me të famshmin Projekti 596 i cili u quajt kështu pas largimit të specialistëve sovjetikë me urdhër të Hushovit në vitin 1959.⁵³ Brenda lidhshimit kinez kishte filluar një përplasje e fortë ndërmjet modernizuesve, që kërkonin një ushtri profesionale dhe të mirëarmatosur dhe ideologëve të cilët e kishin vendosur mbrojtjen e vendit në mobilizimin e masave dhe në luftën popullore me një ushtri popullore.⁵⁴

⁵⁰ Po aty, fl. 103, 111. Letër Valter Ulbrihtit nga Enver Hoxha më 7 tetor 1958.

⁵¹ Po aty, fl. 123, 129. Letër Antonin Novotnit nga Enver Hoxha më 7 tetor 1958.

⁵² Po aty, fl. 131.

⁵³ Robert Bickers, *Out of China; How the Chinese ended the era of Western domination*, St Ives: Allen Lane, 2017, f. 320.

⁵⁴ Po aty.

Në këtë përplasje, krahu modernist humbi betejën politike, por në terma praktikë agjenda e tyre pati avancim të shpejtë, gjë që u kurorëzua më 16 tetor 1964 me shpërthimin e të parës bombë bërthamore nga Republika Popullore e Kinës.⁵⁵ Qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë në mbrojtje të interesave të RPK-së del me një deklaratë të bujshme të firmosur nga Mehmet Shehu, ku dënon me indignatë të thellë provokacionet dhe aktet agresive të SHBA-ve në ngushticën e Tajvanit.⁵⁶ Sipas qeverisë shqiptare kolonizatorët amerikano-angleze kishin pësuar disfatë në Liban e Jordani dhe kishin marrë dënimin moralo-politik në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, tashmë kishin filluar t'i bënin shantazh agresiv me kërcënimin e integritetit tokësor të Republikës Popullore të Kinës dhe se qeveria e RPSH-së njihte vetëm një Kinë, Republikën Popullore të Kinës.⁵⁷

Kërkesat e Shqipërisë për drithëra dhe ushqime të tjera në fundin e viteve '50 dhe në fillim të viteve '60 ishin përherë në rritje. Më 14 dhjetor 1959, kryeministri Mehmet Shehu iu drejtua përsëri homologut të tij kinez Çu En Lai për t'i akorduar Shqipërisë 50 mijë ton grurë për

⁵⁵ *Po aty*; shih edhe Gjon Boriçi, "Mbështetja e Republikës Popullore të Shqipërisë dhënë Republikës Popullore të Kinës në hedhjen poshtë të teorisë së 'dy Kinave' në epokën e Luftës së Ftohtë", kumtesë e mbajtur në Konferencën shkencore ndërkombëtare *Marrëdhëniet shqiptaro-kineze; Tradita, Gjendja dhe e Ardhmja*, në 70-vjetorin e vendosjes së marrëdhënieve midis Shqipërisë dhe Kinës, Vlorë (separat), f. 15, www.researchgate.net/profile/Gjon_Borici; shih edhe: H. Kissinger, *On China* ..., f. 151-180; Philip Short, *Mao; the man who made China*, London: I.B.Tauris, 2017, f. 445; Julia Lovell, *Maoism; a global history*, London: The Bodley Head, 2019, f. 115-116; Elizabeth C. Economy, *The Third Revolution; Xi Jinping and the new Chinese state*, New York: Oxford University Press, 2018, f. 243; Margaret Macmillan, *Nixon and Mao; the week that changed the world*, New York: Random House, 2007, f. 104-105, 108-109.

⁵⁶ *AQSH*, F. 490/KM, V. 1958, D. 1134, fl. 1, 3. Deklaratë e Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë lidhur me gjendjen e krijuar në Ngushticën e Tajvanit.

⁵⁷ *Po aty*, fl. 1-2. Pjesë nga deklarata e qeverisë së RPSH-së: "Qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë dhe populli shqiptar solidarizohen plotësisht me deklaratën e Kryetarit të Këshillit të Shtetit të Republikës Popullore të Kinës, Çu En Lai, të datës 6 shtator 1958, dhe me tërë masat e marra nga Qeveria e Republikës Popullore të Kinës për mbrojtjen e vendit dhe për çlirimin e tokave legjitime kineze, ishujt Tajvan, Penghu etj. që mbahen padrejtësisht nga forcat bandistëse të Çan Kai Shisë nën mbrojtjen e hapët të amerikanëve".

gjashtëmuorin e parë të vitit 1960.⁵⁸ Këtë kërkesë, kryeministri Shehu e justifikoi më faktin se në sektorin e bujqësisë, Shqipëria kishte hasur probleme të mëdha pasi procesi i kolektivizimit dhe mekanizimit nuk po bënte të mundur sigurimin e bukës në vend si dhe kushtet e pafavorshme atmosferike të viteve 1957 dhe 1958 (thatësira) e kishte keqësuar deficitin në drithëra buke.⁵⁹ Edhe për vitin 1959 të korrurat Shqipëria nuk i kishte patur të mira për shkak të shirave të shumtë.⁶⁰ Si me shi e si me thatësi, Shqipëria ishte po njëjloj në vështirësi në sigurimin e bukës në vend për shkak të mosprodhimit të duhur të grurit.⁶¹ Në fund të letrës Mehmet Shehu i shkroi Çu En Lait se ishte i ndërgjegjshëm për vështirësitë e mëdha që po kalonte Kina dhe shprehte bindjen se nuk do t'ia kursente Shqipërisë ndihmën vëllazërore.⁶²

Përgjigjja e Çu En Lait ndaj letrës së Mehmet Shehut erdhi në 15 janar të vitit 1960.⁶³ Kërkesës së Shehut për grurë, kryeministri kinez iu përgjigj se Kina do t'i lëvronte Shqipërisë 30 mijë ton.⁶⁴ Kësaj here Kina nuk e përmbushi plotësisht kërkesën e Shqipërisë për arsye se vetë gjendej në vështirësi të mëdha si pasojë e hopit të madh përpara duke tjetërsuar edhe shifrat e grurit brenda vendit⁶⁵. Duke qenë se marrëdhëniet e Shqipërisë me Bashkimin Sovjetik ishin ende solide, Shqipëria nuk mund të mos pranonte ndihma sado të vogla të ishin ato për të mbajtur frymën gjallë. Mehmet Shehu e falënderoi homologun e tij kinez me një letër të përzemërt më datë 26 mars 1960.⁶⁶ Shqipëria sipas Shehut e konsideronte këtë ndihmë si një shfaqje dashurie të sinqertë që ushqente populli vëlla kinez për popullin shqiptar dhe si një provë të lartë të internacionalizmit proletar.⁶⁷

⁵⁸ AQSH, F. 490/KM, V. 1960, D, 1321, fl. 1, 2. Letërkëmbim ndërmjet Qeverive të Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Republikës Popullore të Kinës për t'i furnizuar Shqipërisë drithëra dhe artikuj të tjerë ushqimorë nga ana e Kinës.

⁵⁹ *Po aty*.

⁶⁰ *Po aty*.

⁶¹ *Po aty*.

⁶² *Po aty*, fl. 2.

⁶³ *Po aty*, fl. 6.

⁶⁴ *Po aty*.

⁶⁵ Frank Dikötter, *Mao's great famine; the history of China's most devastating catastrophe, 1958-1962*, New York: Walker and Co., 2010, f. 310.

⁶⁶ AQSH, F. 490/KM, V. 1960, D, 1321, fl. 9. Letër e Mehmet Shehut për Çu En Lain.

⁶⁷ *Po aty*. Pjesë nga letra e Mehmet Shehut: "Populli shqiptar i cili ushqen ndjenjat e miqësisë vëllazërore ndaj popullit të madh kinez, do ta ruajë e do ta çelnikosë

Pas mbledhjes së Bukureshtit në qershor 1960 dhe tërësisht të ndërjegjshëm se marrëdhëniet me Bashkimin Sovjetik do të merrnin tatëpjetën, më datë 21 korrik 1960, kryeministri shqiptar Mehmet Shehu i drejtohet përsëri me një tjetër letër Çu En Lait për ndihma.⁶⁸ Në letër, Shehu njoftoi kryeministrin kinez për vështirësitë e mëdha që po haste vendi në sektorin e bujqësisë duke ripërsëritur thujtë të njëjtat fjalë si në letrën e funddhjetorit 1959. Sipas Shehut, Shqipëria do të mund të realizonte vetëm 50% planin bujqësor për vitin 1960.⁶⁹ Përsëri kryeministri shqiptar i lutej Çu En Lait që Kina të dërgonte 50 mijë ton grurë për vitin 1960.⁷⁰ Plani për të marrë sasinë e kërkuar të grurit nga Kina kërkonte një studim të hollësishëm të gjendjes. Për këtë arsye, me urdhër të kryeministrit, një ditë më pas, 22 korrik 1960, i dërgohet një letër sqaruese Koço Theodhosit, President i Komisionit të Planit të Shtetit, Kiço Ngjelës, ministër i Tregtisë dhe Behar Shtyllës, ministër i Punëve të Jashtme.⁷¹ Kjo letër do t'i shërbente të tre zyrtarëve të lartë të shtetit për ta mbajtur parasysht?!⁷²

Duke parë këmbënguljen e Shqipërisë, më datë 3 gusht 1960, kryeministri kinez Çu En Lai informoi homologun e tij shqiptar se Kina do ta plotësonte kërkesën e Shqipërisë për 50 mijë ton grurë duke e konsideruar si llogari speciale dhe të zgjidhej më vonë në bisedimet mes dy qeverive.⁷³ Dërgesa prej 50 mijë ton grurë që do t'i lëvrohej Shqipërisë, do të ndahej në dy pjesë: 30 mijë ton grurë do të dërgoheshin gjatë tremujorit të tretë të vitit 1960, dhe 20 mijë ton të tjerë në tremujorin e katërt të po atij viti.⁷⁴ Shqipëria nuk kishte sesi të mos ngazëllohej për këtë ndihmë të rëndësishme që po merrte nga Kina. Më 15 gusht 1960, kryeministri Shehu falënderoi me një letër të posaçme kryeministrin kinez për këtë ndihmë vëllazërore dhënë Shqipërisë.⁷⁵

kurdoherë e më shumë miqësinë e thellë vëllazërore që e bashkon me popullin e madh kinez".

⁶⁸ *Po aty*, fl. 13.

⁶⁹ *Po aty*, fl. 14.

⁷⁰ *Po aty*.

⁷¹ *Po aty*, fl. 19.

⁷² *Po aty*, fl. 20.

⁷³ *Po aty*, fl. 21. Letër e Çu En Lait dërguar Mehmet Shehut më 3 gusht 1960.

⁷⁴ *Po aty*.

⁷⁵ *Po aty*, fl. 24. Në fletën 25 të këtij dokumenti data e përpilimit të letrës është 13 gusht 1960.

Plotësimi i kësaj kërkesë nga ana e Kinës, i hapi oreksin Shqipërisë për të kërkuar të tjera ndihma prej saj. Më 9 shtator 1960, kryeministri Mehmet Shehu i shkroi një tjetër letër informuese kryeministrit Çu En Lai lidhur me vështirësitë ekonomike të Shqipërisë.⁷⁶ Sipas Shehut, plani i prodhimit të drithërave në Shqipëri nuk parashikohej të ishte më shumë se 40-45% duke i krijuar vendit një deficit prej 270 mijë ton.⁷⁷ Shqipëria sipas kryeministrit në asnjë mënyrë nuk mund ta zgjidhte furnizimin e popullsisë me bukë gjatë viteve 1960 dhe 1961 vetëm duke u mbështetur në forcat e brendshme.⁷⁸ Kur kishte kaluar veçse një muaj nga aprovimi i kërkesës së 3 gushtit, Mehmet Shehu pati guximin e tepruar t'i kërkonte përsëri ndihma Kinës kësaj radhe disa herë më të mëdha. Këto kërkesa për ndihmë renditeshin si më poshtë:

1. 140 mijë ton drithëra buke, nga të cilat 100 mijë ton të ishin grurë dhe 40 mijë ton misër. Kjo sasi duhej të vinte në Shqipëri në masën 20 mijë ton çdo muaj përgjatë vitit 1961, duke filluar nga muaji dhjetor 1960.

2. 2 mijë ton oriz dhe 3 mijë ton yndyra ushqimore për periudhën 1961-1965. Gjithashtu të dërgohej edhe një sasi prej 6 mijë ton sheqer për tremujorin e parë dhe të dytë të vitit 1961.⁷⁹

Kjo kredi e re nga ana e Kinës, kryeministri Shehu kërkonte që të ishte me afat të gjatë dhe të fillonte të shlyhej nga ana e Shqipërisë pas vitit 1980.⁸⁰ Padyshim, kryeministri Shehu do të duhej ta justifikonte këtë kërkesë të re për kredi që po i parashtronte në një kohë kaq të shkurtër Kinës. Arsyeja qëndronte në faktin se Bashkimi Sovjetik dhe vendet e demokracive popullore (Bullgarisë, Rumanisë dhe Hungarisë) kërkesës së Shqipërisë për një sasi prej 80 mijë ton drithë, nuk i kishin kthyer asnjë përgjigje.⁸¹ Vendi gjendej në situatë dëshpërimi. Kjo vërtetohet nga pjesa në letër ku Shehu i kërkon me urgjencë Kinës akordimin e një ndihme prej 1.500.000 dollarësh amerikanë në valutë të lirë, pa interes për të blerë 20 mijë ton drithë në vendet perëndimore vetëm për muajt shtator dhe tetor 1960.⁸² Edhe pse klika komuniste shqiptare ishte e bindur se

⁷⁶ *Po aty*, fl. 22.

⁷⁷ *Po aty*.

⁷⁸ *Po aty*, fl. 23.

⁷⁹ *Po aty*, fl. 27.

⁸⁰ *Po aty*, fl. 28.

⁸¹ *Po aty*.

⁸² *Po aty*.

marrëdhëniet me Bashkimin Sovjetik kishin prekur fundin, përsëri në fund të letrës Mehmet Shehu shprehte besimin se vendi i tij do t'i kalonte këto vështirësi me forcat e veta dhe me miqësinë e Kampit Socialist të kryesuar nga Bashkimi Sovjetik.⁸³

Përgjigjja nga kryeministri Çu En Lai i kërkesave të Mehmet Shehut erdhi më 20 tetor 1960.⁸⁴ Kryeministri kinez njoftoi homologun e tij shqiptar se Kina do të plotësonte të gjitha kërkesat e Shqipërisë madje, përveç 50 mijë ton grurë do t'i dërgonte edhe 140 mijë ton të tjerë të ndarë në 100 mijë ton grurë dhe 40 mijë ton misër.⁸⁵ Gjithashtu, përveç sasisë së orizit dhe të vajrave të caktuar me marrëveshje tregtare me afat të gjatë për vitet 1961-1965, Kina i shtonte dërgesës për Shqipërinë edhe 2 mijë ton oriz, 3 mijë ton vajra dhe 6 mijë ton sheqer.⁸⁶ Të gjitha këto mallra do të dërgoheshin në Shqipëri në tremujorin e parë dhe të dytë të vitit 1961.⁸⁷ Qeveria kineze përveç kësaj ndihme me bujari të tepruar, shkoi edhe më tej duke i akorduar Shqipërisë si kredi pa përqindje shumë prej 1.500.000 US\$ të financuar nga Banka Popullore e Kinës sipas urdhrat përkatës.⁸⁸ Po ashtu, Çu En Lai njoftoi kryeministrin Shehu se në qoftë se Bashkimi Sovjetik dhe vendet e tjera të demokracive popullore nuk do ta furnizonin Shqipërinë me sasinë e drithërave të kërkuar nga Shqipëria (80 mijë ton), qeveria kineze do ta furnizonte pjesërisht ose tërësisht këtë sasi drithërash, e cila i nevojitej Shqipërisë.⁸⁹ E gjithë kjo ndihmë që Kina po i jepte Shqipërisë ishte në frymën e internacionalizmit proletar për të ndihmuar popullin heroik shqiptar i cili sipas kryeministrit kinez qëndronte në avanpostin e Kampit Socialist.⁹⁰

Kryeministri Mehmet Shehu më datë 2 nëntor 1960, falënderoi ngrohtësisht homologun e tij për ndihmën e madhe që kishte siguruar Shqipëria nga Kina.⁹¹ Qysh me fillimin e marrëdhënieve shqiptaro-

⁸³ *Po aty*, fl. 29.

⁸⁴ *Po aty*, fl. 34.

⁸⁵ *Po aty*.

⁸⁶ *Po aty*.

⁸⁷ *Po aty*.

⁸⁸ *Po aty*, fl. 35.

⁸⁹ *Po aty*.

⁹⁰ *Po aty*.

⁹¹ *Po aty*, fl. 39-40. Pjesë nga letra e Mehmet Shehut dërguar Çu En Lait: "...Ne shohim në popullin e madh dhe të talentuar kinez, në Qeverinë e Republikës Popullore të Kinës dhe në Partinë e lavdishme Komuniste Kineze, luftëtarët e pamposhtur për çështjen tonë të përbashkët, për triumfin e ideve ngadhënjimtare të marksizëm-

kineze, vendi i madh aziatik kishte filluar dalëngadalë dhe pa u ndier të zëvendësonte çdo partner të mundshëm politik dhe ekonomik të Shqipërisë në kampin e socializmit.

Më 7 tetor 1961, kur marrëdhëniet shqiptaro-sovjetike ishin në grahmat e fundit, Mehmet Shehu i drejtohet me një letër tjetër kryeministrit kinez Çu En Lai.⁹² Kësaj radhe Shqipëria kërkonte nga Kina një kredi të re prej 40 milion rublash dhe 40 mijë ton grurë.⁹³ Këtë kërkesë të re, Shehu e justifikoi me faktin se në rrethanat politike të krijuara ndërmjet Shqipërisë e Bashkimit Sovjetik dhe vendeve të tjera të demokracive popullore në Evropë, vendi mund të gjendej në bllokadë tregtare madje të pengohej edhe në shkëmbimin reciprok të mallrave.⁹⁴ Në këtë letër, Shehu e kishte të pamundur të mos përfshinte premtimin e Hrushovit të datës 25 prill 1960 me anë të së cilës qeveria sovjetike pranonte kërkesën shqiptare për shtyrjen e shlyerjeve financiare të ratave për 10-15 vjet.⁹⁵ Siç shikohet, Bashkimi Sovjetik po bënte të gjitha përpjekjet që marrëdhëniet me Shqipërinë të mos shkonin në acarime të mëtejshme duke patur edhe informacione për afrimin e pazakontë shqiptaro-kinez. Kredia e re që kërkonte Shqipëria, nevojitej për periudhën 1963-1967 dhe të shlyhej me mallrat e eksportit shqiptar.⁹⁶

Mehmet Shehu sqaronte homologun e tij kinez se Shqipëria do të bënte të gjitha përpjekjet për të vijuar tregtinë e shkëmbimit të mallrave me Bashkimin Sovjetik dhe vendet e tjera të demokracive popullore në Evropë.⁹⁷ Nëse këto vende nuk do të pranonin një gjë të tillë, atëherë Shqipëria do të vijonte t'i drejtohej Kinës për ndihmë. Për vitin 1962, Shqipëria përveç kredisë i kërkonte Kinës që përveç 90 mijë ton grurë t'i akordonte edhe 40 mijë ton grurë që do të shlyhej në periudhën 1963-1965.⁹⁸ Për bisedime, Shqipëria ishte e gatshme të dërgonte në Pekin një delegacion të lartë ekonomik të kryesuar nga zëvendëskryetari i Këshillit

leninizmit, shohim ndjenjat tuaja të larta të internacionalizmit proletar, vendosmërinë Tuaj për triumfin e socializmit dhe të komunizmit në të gjithë botën".

⁹² *AQSH*, F. 490/KM, V. 1961, D. 1153, fl. 1. Kërkesë e Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë drejtuar Qeverisë së Republikës Popullore të Kinës për akordim kredie.

⁹³ *Po aty*, fl. 2.

⁹⁴ *Po aty*.

⁹⁵ *Po aty*.

⁹⁶ *Po aty*.

⁹⁷ *Po aty*, fl. 3.

⁹⁸ *Po aty*.

të Ministrave, Abdyl Këllezi.⁹⁹ Kjo kërkesë e Shqipërisë për kredi të re nga ana e Kinës nëse pati përgjigje, dokumentet nuk na e sqarojnë.

Fundi i marrëdhënieve të gjithanshme të Shqipërisë me Bashkimin Sovjetik kishte bërë që vendi i vogël komunist ballkanik të kërkonte ndihmë nga të gjitha anët. Në Evropën Lindore dera i ishte mbyllur plotësisht pasi të gjitha vendet ishin nën autoritetin politik dhe ekonomik të Bashkimit Sovjetik. Me Evropën Perëndimore, Enver Hoxha kishte vendosur të mos bashkëpunonte. Në këtë situatë dëshpërimi, Shqipëria me anë të kryeministrit Mehmet Shehu i drejtohet me një letër kryetarit të Koresë së Veriut, Kim Ir Sen, më 7 tetor 1961.¹⁰⁰ Për plotësimin e planit të tretë pesëvjeçar 1961-1965 që do të aprovohej nga Kongresi IV i PPSH-së, qeveria e Republikës Popullore e Shqipërisë i kërkonte qeverisë së Republikës Popullore të Koresë një kredi prej 30 milionë rublash.¹⁰¹ Kjo kredi kërkohej për vitet 1962-1965 për të përfunduar objektet industriale të veçanta, pajisjet për zgjerim ofiçinash dhe uzinave mekanike ekzistuese në Shqipëri. Kjo kredi kërkohej të shlyhej duke filluar nga viti 1980 e më tej.¹⁰² Shqipëria ishte e gatshme sipas Shehut të dërgonte menjëherë në Phenian një delegacion të lartë qeveritar për bisedime të kryesuar nga zëvendëskryetari i Këshillit të Ministrave, Abdyl Këllezi.¹⁰³ Kjo kredi nëse do të akordohej nga Republika Popullore e Koresë së Veriut do të ishte sipas Shehut një ndihmë e madhe efektive për popullin shqiptar, për ndërtimin e socializmit në Shqipëri.¹⁰⁴

Përgjigja nga ana e Kim Ir Senit erdhi pas gati dy muajsh, më datë 30 nëntor 1961.¹⁰⁵ Në letër Kim Ir Seni shprehte keqardhjen se si pasojë e luftës në përpjekje për të rimëkëmbur ekonominë dhe për të përsheptuar bashkimin e dy Koreve, ekonomia e vendit gjendej ende në nivel të ulët

⁹⁹ *Po aty*.

¹⁰⁰ *AQSH*, F. 490/KM, V. 1961, D. 1154, fl. 1. "Letër këmbim ndërmjet Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Demokratike Popullore të Koresë për kërkesën e një kredie Shqipërisë".

¹⁰¹ *Po aty*.

¹⁰² *Po aty*, fl. 2.

¹⁰³ *Po aty*.

¹⁰⁴ *Po aty*.

¹⁰⁵ *Po aty*, fl. 8. Letër e Kim Ir Sen, kryetar i Kabinetit të Ministrave të Republikës Demokratike Popullore të Koresë dërguar kryetarit të Këshillit të Ministrave të Republikës Popullore të Shqipërisë, Mehmet Shehu.

dhe se për shkak të kësaj gjendjeje kërkesa e Shqipërisë nuk mund të plotësohej nga ana e Koresë së Veriut.¹⁰⁶

Më 18 shtator 1962, zëvendëskryetari i Këshillit të Ministrave të Republikës Popullore të Shqipërisë, Abdyl Këllezi, pati një takim sekret me ambasadorin e Republikës Popullore të Kinës në Shqipëri, Lo Shi Gao.¹⁰⁷ Në protokollin e nënshkruar në Pekin më 23 prill 1961, Kina pranonte të ndihmonte Shqipërinë në dërgimin e pajisjeve dhe dhënien e ndihmës teknike Shqipërisë për përfundimin e ndërtimit të 25 veprave industriale.¹⁰⁸ Por, sipas Abdyl Këllezit, po haseshin vështirësi në përfundimin e veprave në afatet e përcaktuara pasi skicat për disa prej objekteve nuk po dorëzoheshin në kohë nga Kina.¹⁰⁹ Po ashtu, edhe për materialet e ndërtimit që parashikoheshin në marrëveshje të vinin nga Kina ende nuk ishte bërë asnjë kontraktim. Gjithashtu, pritej që të vinin nga Kina specialistë kinezë për të dhënë ndihmë teknike në ndërtimin e 25 veprave, si dhe të dërgoheshin specialistë shqiptarë në RPK për t'u trajnuar për vënien në shfrytëzim të këtyre veprave.¹¹⁰ Më pas, zëvendëskryeministri Këllezi e përqendroi bisedën tek rëndësia e veçantë që do të kishte për ekonominë shqiptare ndërtimi i uzinës për prodhimin e plehrave azotikë për zhvillimin e mëtejshëm të bujqësisë.¹¹¹ Këtë kërkesë Abdyl Këllezi ia parashitroi ambasadorit kinez si një detyrë urgjente për të plotësuar brenda kushteve të caktuara në mënyrë që të fillonte sa më parë ndërtimi i saj.¹¹²

Në parashtrimin e çështjeve për ndërtimin e 25 veprave për pesëvjeçarin e tretë, Abdyl Këllezi i tregoi ambasadorit kinez edhe grafikun përkatës sesa do të ishte vëllimi financiar i këtyre veprave. Gjysma e dytë e vitit 1962 do të kërkonte një shpenzim prej 120 milion lekësh, ndërsa për vitin 1963 parashikohej që kjo vlerë të shkonte në 1.6 miliard lekë.¹¹³ Në mungesë të projekteve të paraqitura nga pala shqiptare

¹⁰⁶ *Po aty*.

¹⁰⁷ *AQSH*, F. 490/KM, V. 1962, D. 1237, fl. 1. Shënime dhënë ambasadorit të Republikës Popullore të Kinës në Shqipëri nga zëvendëskryetari i Këshillit të Ministrave, Abdyl Këllezi, për ndihma lidhur me hartimin e projekt-detyrave të zgjeruara të 25 veprave të planit të tretë pesëvjeçar.

¹⁰⁸ *Po aty*, fl. 2.

¹⁰⁹ *Po aty*.

¹¹⁰ *Po aty*.

¹¹¹ *Po aty*.

¹¹² *Po aty*.

¹¹³ *Po aty*, fl. 5.

për vitin 1962, ndërtimi i veprave kishte ngecur, ndërsa për vitin 1963 vështirësitë e vitit të mëparshëm do të pengonin kryerjen e ndërtimeve të parashikuara.¹¹⁴ Në këtë bashkëbisedim ka një kontradiktë nga ana e Abdyl Këllezit pasi në fund shprehet se për ndërtimin e 25 veprave Shqipëria i kishte marrë të gjitha masat tekniko-organizative të nevojshme në mënyrë që punimet e ndërtimeve tek ato vepra të kryheshin shpejt e mirë¹¹⁵, kur pak më përpara kishte pranuar mungesën e projekteve nga pala shqiptare. Megjithatë, në fund të bisedës Abdyl Këllezit shprehte besimin se pala kineze do t'i miratonte kërkesat e Shqipërisë.¹¹⁶

"Era e Lindjes mbisundoftë mbi atë të Perëndimit"

Duke qenë se Kina në këtë kohë në Evropë kishte vetëm një mik të vetëm¹¹⁷, Shqipërinë, në përpjekjet e saj për ta ndërkombëtarizuar situatën për të treguar të drejtën e saj në konfliktin me Kinën, më datë 27 tetor 1962, kryeministri indian Xhawaharlal Nehru, i dërgon një letër informuese kryeministrit shqiptar Mehmet Shehu.¹¹⁸ Kryeministri indian Nehru, në mesazhin drejtuar Mehmet Shehut e paraqet çështjen e konfliktit në kufi me Kinën si shumë serioze si pasojë e agresionit kinez.¹¹⁹ Pasojat e këtij agresioni sipas Nehrusë nuk ishin serioze vetëm për Indinë, por për të gjithë botën.¹²⁰ Për Indinë, urrejtja për luftën dhe dhunën ishte pjesë e traditës kombëtare të vendit.¹²¹ Gjithmonë India edhe para pesë vjetësh kur kishte nisur agresioni në Lardakh, kishte treguar vetëpërmbajtje.¹²² Edhe pse 12 mijë milje të territorit indian ishin

¹¹⁴ *Po aty.*

¹¹⁵ *Po aty.*

¹¹⁶ *Po aty*, fl. 6.

¹¹⁷ Robert Bickers, *Out of China...*, f. 287-288; F. Dikötter, *Mao's great famine...*, f. 108. "Të gjitha marrëdhëniet tregtare me kampin socialist ishin reduktuar, me përjashtim të Shqipërisë".

¹¹⁸ *AQSH*, F. 490/KM, V. 1962, D. 1239, fl. 1. Mesazh i Kryeministrit të Indisë dhe përgjigjja e qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë për konfliktin kufitar indiano-kinez dhe biseda e kryetarit të Këshillit të Ministrave të Republikës Popullore të Shqipërisë me të Ngarkuarin me Punë të Republikës Popullore të Kinës në Shqipëri për këtë çështje.

¹¹⁹ *Po aty.*

¹²⁰ *Po aty.*

¹²¹ *Po aty.*

¹²² *Po aty.*

pushtuar nga forcat kineze, India nuk kishte përshkallëzuar krizën madje kishte bërë propozime të shumta për ta zgjidhur çështjen me mjete paqësore.¹²³ I gjithë problemi i këtij konflikti ishte përse i përket kufirit tibetan-indian. Atë kohë, Kina kishte shtrirë autoritetin e saj në Tibet duke cenuar sipas kryeministrit kinez integritetin kufitar të Indisë.¹²⁴ Forcat kineze kishin sulmuar në mënyrë të papritur më 8 shtator 1962 duke hyrë sipas Nehrusë në territorin indian.¹²⁵ Sulmi kinez u përsërit përsëri një muaj më vonë më 20 tetor 1962 në të gjithë gjatësinë e kufirit me Indinë duke i dhënë konfliktit përmasa gjithëpërfshirëse.¹²⁶ Sipas Nehrusë, gjithnjë kinezët në marrëdhëniet me Indinë e kishin shpërblyer të mirën me të keqe dhe se marrëdhëniet miqësore me Kinën kishin qenë baza e politikës qëkur vendi i tij ishte shpallur i pavarur.¹²⁷

Në fund të letrës prej katër faqesh, kryeministri indian i shprehet Mehmet Shehut se shpresonte në mirëkuptimin dhe simpatinë e Shqipërisë ndaj Indisë kundër agresionit kinez.¹²⁸

Si mund të shprehte simpati dhe përkrahje Republika Popullore e Shqipërisë edhe sikur Kina ta kishte gabim në konfliktin me Indinë kur sistemi i saj politik dhe ekonomik po mbahej në këmbë vetëm nga ndihmat dhe kreditë kineze? Përgjigjja që Mehmet Shehu i kthen letrës së kryeministrit Nehru më datë 31 tetor 1962 është shumë kuptimplotë:

"...Qeveria shqiptare nuk mund kurrsesi të pajtohet me akuzën për agresion që ju i drejtoni Republikës Popullore të Kinës e cila, si në marrëdhëniet me Indinë, duke përfshirë edhe çështjen e kufirit shtetëror kino-indian, ashtu edhe në marrëdhëniet me shtetet e tjerë, ndjek një politikë paqësore konsekuente, që gëzon përkrahjen tonë dhe të vendeve të tjera paqedashëse".¹²⁹

Po atë datë [31 tetor] kryeministri Shehu ishte "sqsuar" nga i Ngarkuari me Punë i Republikës Popullore të Kinës, Van Lu Min, lidhur me konfliktin kino-indian.¹³⁰ Mehmet Shehu nuk kishte pse dëgjonte

¹²³ *Po aty.*

¹²⁴ *Po aty.*

¹²⁵ *Po aty*, fl. 2.

¹²⁶ *Po aty.*

¹²⁷ *Po aty.*

¹²⁸ *Po aty.*

¹²⁹ *Po aty*, fl. 3. Letra e Mehmet Shehut dërguar Xhavarharlal Nehrusë, Kryeministër i Indisë.

¹³⁰ *Po aty*, fl. 4. Takimi i Mehmet Shehut me Van Lu Min, më 31 tetor 1962.

"s qarimet" për konfliktin nga i Ngarkuari me Punë i RPK-së në Tiranë, por që në fillim të bisedës e falënderoi për ndihmën që vendi i tij i jepte Shqipërisë për ndërtimin e 25 veprave të parashikuara për pesëvjeçarin e tretë.¹³¹ Kina për Shqipërinë kishte harxhuar shumë para për të blerë në Itali të gjitha pjesët që duheshin për të ndërtuar fabrikën e plehrave azotikë.¹³² Mehmet Shehu nxitoi ta informonte të Ngarkuarin me Punë të RPK-së lidhur me mesazhin që kishte marrë nga kryeministri indian dhe përgjigjen që i kishte kthyer ai në emër të qeverisë shqiptare. Në këtë çast pati edhe një moment gazmor ndërmjet dy bashkëbiseduesve kur Shehu i thotë Van Lu Minit se "kryeministri indian kërkoi mbështetjen e Shqipërisë kundër Kinës".¹³³ Të dyja letrat (edhe të kryeministrit indian edhe të qeverisë shqiptare) Mehmet Shehu ia dorëzoi Van Lu Minit. Duke qenë se biseda mori tone gazmore, Mehmet Shehu i thotë të Ngarkuarit me Punë se nëse Nehruja do t'i kërkonte aleatit të tij në Ballkan, Jugosllavisë të sulmonte Shqipërinë, ajo [Shqipëria] asnjëherë nuk do t'i drejtohej për ndihmë Nehrusë, por do t'ia kthente Jugosllavisë me pushkë me armët që kishte marrë nga Kina.¹³⁴ Për më tepër, kryeministri shqiptar e informoi të Ngarkuarin me Punë të RPK-së në Tiranë, për mbrojtjen e rreptë që i kishte bërë Shqipëria të drejtave legjitime të Kinës për t'u anëtarësuar në OKB në një kohë kur ishte sulmuar atje nga SHBA, India etj., shtete kapitaliste dhe aleatë të tyre në lidhje me konfliktin me Indinë.¹³⁵ Lu Van Mini shprehu në emër të qeverisë së RPK-së mirënjohjen për Shqipërinë për ndihmën e madhe që i kishte dhënë Kinës në OKB.¹³⁶

¹³¹ *Po aty*.

¹³² *Po aty*. Pjesë nga takimi: "Mehmet Shehu: Ne jemi thellësisht të prekur nga ky kujdes dhe nga kjo ndihmë e madhe internacionaliste, absolutisht internacionaliste, që po na jep Qeveria dhe Partia juaj dhe kurrë nuk do ta harrojmë".

¹³³ *Po aty*, fl. 5.

¹³⁴ *Po aty*.

¹³⁵ *Po aty*, fl. 6. Pjesë nga fjala e Mehmet Shehut: "Prandaj i kishim dhënë me kohë direktiva përfaqësuesit tonë në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, Halim Budos, që në rast se do të ngrihej e të shpifte njeri kundër Republikës Popullore të Kinës, atëherë ai të ngrihej e ta mbronte aleatin tonë – Republikën Popullore të Kinës në mënyrën më të rreptë...Përfaqësuesit e delegacionit amerikan dhe Indian shikonin nga delegacioni sovjetik dhe delegacionet e vendeve të tjera socialiste, por ata, të gjithë, ulën kokën me turp dhe asnjeri nuk guxoi të dilte e të mbronte Republikën Popullore të Kinës si delegacioni shqiptar".

¹³⁶ *Po aty*, fl. 12.

Në fund të bisedës, Mehmet Shehu e njoftoi Lu Va Minin se kryeministri indian nuk e kishte botuar mesazhin dërguar Shqipërisë, kështu që edhe Shqipëria nuk do ta bënte publik dhe kjo sipas Shehut, ishte një gjë e mrekullueshme pasi gjendja e përgjithshme ishte e mirë.¹³⁷ Si për t'i dhënë fundit të bisedës një frymë "shenjtërie" socialiste, Mehmet Shehu e mbyll takimin me një tip lutje:

"Era e Lindjes mbisundoftë mbi atë të Perëndimit".¹³⁸

Përfundime

Gjysma e dytë e viteve '50 dhe fillimi i viteve '60 në historinë politiko-ekonomike të Shqipërisë me vendet e Kampit Socialist, shënojnë ndryshim të madh. Varësia totale e vendit të vogël ballkanik ndaj ndihmave dhe kredive jo vetëm sovjetike, por të të gjithë Kampit Socialist, ishte e përmasave të jashtëzakonshme. Keqpërdorimi i këtyre kredive duke i dhënë përparësi thujse absolute vetëm industrisë së rëndë, do të ndrydhte fuqinë ekonomike të vendit për të mbijetuar gjithmonë vetëm me ndihma dhe kredi dhe asnjëherë për të ecur me këmbët e veta. Vetëm nga vendet e ish Kampit Socialist me në krye Bashkimin Sovjetik, Shqipëria do të merrte 780 milion rubla të barabarta me po kaq dollarë amerikanë duke qenë se rubla dhe dollari ishin të barabarta në kursin e këmbimit gjatë viteve '50 dhe '60.¹³⁹

Megjithëse nga vendet evropiane të Kampit Socialist shifra e kredive të marra ishte marramendëse për ekonominë shqiptare, duket se Enver Hoxhës nuk i mjaftonin. Lidhja e tij me Republikën Popullore të

¹³⁷ *Po aty*, fl. 13.

¹³⁸ *Po aty*. Pjesë nga fjala e Mehmet Shehut: "Po ta shohësh objektivist, kështu është. Mirëpo deri sa nuk kishte lindur Republika Popullore e Kinës, midis Lindjes, socializmit nga njëra anë, dhe imperializmit nga ana tjetër, frynte era edhe kështu edhe ashtu, domethënë kishte një farë ekuilibri forcash. Por lindja e Republikës Popullore të Kinës në vitin 1949 e ndryshoi raportin e forcave në arenën ndërkombëtare dhe filloi ta mundi era e lindjes erën e perëndimit, si ai dragoi legjendar i Kinës që ka mundur shpirtërat e këqij dhe ka vazhduar kështu. Por lindi një forcë e re brenda për brenda lëvizjes komuniste, revizionizmi. Në Bukuresht era e Lindjes filloi të fryjë edhe në fytyrat e revizionistëve dhe të mbisundojë jo vetëm kundër imperializmit, por edhe kundër revizionizmit. Kur themi era e lindjes, do të thotë era e marksizëm-leninizmit. Pas tradhtisë dhe kapitullimi të N. Hrushovit në Kubë, kjo era e Lindjes do të transformohet në furtunë; prandaj s'ka pse të mos jemi optimistë".

¹³⁹ F. Dikötter, *Mao's great famine...*, f. 74. Kursi i këmbimit rubël/yuan ka qenë 1 rubël=2.22 yuan, dhe rubël/dollar 1 me 1 për vitet '50-'60.

Kinës ishte një tjetër burim të ardhurash të mëdha për pushtetin e tij. Edhe kreditë që mori për këtë hark kohor që trajtuam në këtë artikull ishin jashtëzakonisht të mëdha. Vetëm për harkun kohor 1954-1960 nga Republika Popullore e Kinës, Shqipëria ka marrë 336.500.000 rubla.¹⁴⁰ Pas prishjes së marrëdhënieve me Bashkimin Sovjetik dhe pas ndërprerjes së ndihmave dhe kredive nga të gjitha vendet evropiane të Kampit Socialist, Shqipëria duke filluar nga dhjetori i vitit 1954 mori nga Kina deri në vitin 1962 sipas dokumenteve që kemi hulumtuar deri tani, 500 milion rubla.¹⁴¹ Siç shikohet, nga viti 1954 kur startoi edhe kredia e parë kineze*, dhe deri në vitin 1962, nga i gjithë Blloku Lindor, Shqipëria ka marrë gjithsej 1.616.500.000 rubla për një popullsi prej afro 1.3 milion banorë. Po të bëjmë një krahasim me vendet evropiano-perëndimore të cilat morën kredi nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës në kuadër të Planit Marshall,¹⁴² Shqipëria do të duhej t'ia kishte kaluar disa herë me rritje ekonomike nëse të gjithë këto para do të ishin investuar në mënyrën e duhur.

S u m m a r y

THE ECONOMIC DEPENDENCE OF ALBANIA FROM THE AIDS AND LOANS BY THE SOCIALIST CAMP AND THE PEOPLE'S REPUBLIC OF CHINA 1956-1962

The second half of the '50ies and the beginning of the '60ies in the political-economic history of Albania with the countries of the socialist camp,

¹⁴⁰ Gjon Boriçi, *Fillimet e marrëdhënieve politiko-ekonomike shqiptaro-kineze 1954-1960* (në proces botimi), f. 210.

¹⁴¹ Gj. Boriçi, *Marrëdhëniet shqiptaro-kineze në Luftën e Ftohtë...*, f. 115

* Shih artikullin tim "Dorëheqja e detyruar e Enver Hoxhës si Kryeministër i RPSH-së dhe kredia e parë kineze akorduar Shqipërisë, 1954", në *Studime historike*, nr. 34, ASA, Instituti i Historisë, Tiranë: 2019.

¹⁴² Gjon Boriçi, "Evropa Perëndimore apo Kina? Një vlerësim në terma interesi ekonomik përse u shpëtua Evropa Perëndimore nga komunizmi dhe u braktis Kina e nacionalistëve të Çan Kai Shisë tek komunistët e Mao Ce Dunit nga Xhorxh Marshall në fillimet e Luftës së Ftohtë, 1945-1949", në *Roli i parasë gjatë luftërave*, Punimet e Konferencës së dytë të Muzeut të Bankës së Shqipërisë, Tiranë, 20 shtator 2018, Tiranë: Banka e Shqipërisë, 2019, f. 165. "Vendet që përfituan më shumë ishin Britania e Madhe me 3.2 miliardë dollarë (sot 32 miliardë dollarë), Franca 2.7 miliardë dollarë (sot 27 miliardë dollarë), Italia 1.5 miliardë dollarë (sot 15 miliardë dollarë) dhe Gjermania Perëndimore 1.4 miliardë dollarë (sot 14 miliardë dollarë)".

mark a great change. The total dependence of the small Balkan country towards the not only Soviet aids and loans, but the entire socialist camp was of extraordinary dimensions. The misuse of these loans giving nearly absolute priority of heavy industry, not only would wrench the economic power of the country to only survive by the aids and loans and never would walk on its own feet. Only from the former countries of the socialist camp headed by the Soviet Union, Albania would be granted 780 million rubles to the same equal exchange to the American dollar. After the break off with the Soviet Union and after the interruption of all the credits and loans from the countries of the socialist camp, Albania was granted by China until 1962 according to the documents I have seen the sum of 500 million rubles. As it's seen, from 1954 when started the first Chinese loan to 1962, from the entire eastern bloc, Albania was granted the sum of 1.616.500.000 rubles for a population of barely 1.3 million inhabitants. If we make a comparison with the western European countries who were granted credits by the United States of America within the framework of the Marshal Plan, Albania would had to surpass them economically multiple times if all this money would have been properly invested.